



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 dhe 61 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 5,6, dhe 7 të Udhëzimit administrativ (MPL) nr.02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në Komuna si dhe nenit 20 par. 20.1 dhe 44 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 24.12.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M PËR EMËRIMIN E NËNKRYETARIT TË KOMUNËS PËR KOMUNITETE

Neni 1 Emërimi

Lulzim Qerimi nga Magura me përgaditje profesionale superiore – drejtimi administratë publike nga komuniteti jo shumicë ashkali, **emërohet** Nënkyetar i Komunës për Komunitete në Komunën e Lipjanit.

Neni 2 Përgjegjësitë

1. Nënkyetari i Komunës për Komunitete e ndihmon Kryetarin në kryerjen e detyrave të tij,
2. Ofron këshilla dhe udhëzime lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet jo shumicë,
3. Mbështet dhe afirmon kërkesat e komuniteteve jo shumicë në organet e Komunës.

Neni 3 Mandati

Mandati i Nënkyetarit të Komunës për Komunitete është i njëjtë me atë Kryetarit të Komunës.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 112-78077

Lipjan, më 24.12.2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Isuf Azem

